

Objekti

Asistencë financiare

Nr. 178

Ekspert përmbajtjeje / Departamenti(et) koordinues
e lëshimit

Data e mëparshme e lëshimit Data

Administrata e korporatës

06/20/2008 12/29/2015

QËLLIMI

Qëllimi i kësaj police është identifikimi dhe asistimi i pacientëve të cilët nuk kanë sigurim shëndetësor dhe kanë nevojë për ndihmë që të paguajnë faturat e tyre të spitalit. Kjo policë aplikohet për të gjitha fushat/sectorët e shërbimit të Spitaleve Beaumont Health. Secili spital, Beaumont Hospital – Grosse Pointe, Beaumont Hospital – Royal Oak, Beaumont Hospital – Troy, Beaumont Hospital – Farmington Hills, Beaumont Hospital – Dearborn, Beaumont Hospital – Wayne, Beaumont Hospital – Taylor dhe Beaumont Hospital – Trenton (bashkërisht përbëjnë “Beaumont Health ose Spitali(et)”) do të reklamojnë gjerësisht këtë policë për anëtarët e publikut në komunitete që këto spitale u shërbejnë.

Kjo policë hartohet me qëllim për të plotësuar kërkesat e Seksionit 501(r) të Kodit të të Ardhurave të Brendshme të 1986-ës, ndryshuar në (“Kod”) lidhur me asistencën financiare dhe policat e kujdesit të shërbimit mjekësor të urgjencës, kufizimet mbi detyrimet për personat e kualifikuar për asistencë financiare, tarifimin e arsyeshëm dhe përpjekjet kolektive dhe do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Nëse kjo policë aplikohet lidhur me një pacient të caktuar, atëherë ajo refuzon aplikimin e Policës përkatëse të Zbritjes për Pacientin e Pasiguruar për këtë pacient. Aplikimi i kësaj police ndaj çdo pacienti individual është subjekt i përfundimit të pranueshëm të aplikimit për asistencë financiare me të gjitha dokumentacionet e nevojshme. Çdo pacient që refuzon të plotësojë në mënyrë të kënaqshme aplikimin e asistencës financiare përfshirë dokumentacionin shoqërues nuk është i kualifikuar për asistencë financiare sipas kësaj police (me kusht që pacienti të ketë marrë njoftimet që kërkohen nga aktet e propozuara normative sipas Seksionit 501(r)).

Si pasojë, polica përfshin:

- Kriteret e kualifikimit për asistencë financiare dhe kujdes falas;
- Bazën për llogaritjen e shumave që iu tarifohen pacientëve sipas kësaj police;
- Metodat me të cilat pacientët aplikojnë për asistencë financiare sipas kësaj police;
- Kufizimet për veprimet që mund të merren në rast të një mospagese përfshirë aksionet e mbledhjeve dhe raportimet tek agjencitë e kredive;
- Metodat me të cilat Beaumont Health do të reklamojë gjerësisht policën brenda komuniteteve që u shërben.
- Kufizimet mbi shumat e tarifuara për kujdesin e shërbimit të urgjencës ose shërbime të tjera të nevojshme mjekësore, që iu ofrohen individëve të kualifikuar për asistencë financiare sipas kësaj police jo më tepër se shumat e tarifuara në përgjithësi.

Deri në atë masë që çdo policë tjetër e Beaumont Health ose pjesë të policës bien në kundërshtim me këtë policë dhe/ose Seksionin 501(r) të Kodit dhe Aktet e zbatueshme Normative të Taksave mbi të Ardhurat (“aktet normative”), do të mbizotërojë kjo policë dhe/ose Seksioni 501(r). Kjo policë është e bazuar në aktet e propozuara normative sipas Seksionit 501(r) ekzistues nga hyrja e kësaj police në fuqi. Beaumont Health ruan të drejtën për ta ndryshuar këtë policë në rast të ndonjë ndryshimi të akteve të propozuara normative.

REFERIMI I PACIENTIT

Stafi i spitalit përgjegjës për planifikimin e takimeve ose regjistrimit duhet t'i rekomandojë të gjithë pacientët e pasiguruar dhe që nuk kanë mundësi të paguajnë te një konsulent financiar për kujdes për të përcaktuar kualifikimin për asistencë financiare. Pacienti i siguar që nuk mund të përballojë të paguajë pjesën e tyre të shumës së përgjithshme duhet të rekomandohet po ashtu te një konsulent financiar.

KUJDESI I NEVOJSHËM MJEKËSOR

Shërbimet dhe artikujt (përveç kujdesit të shërbimit të urgjencës) duhet të jenë të nevojshme nga ana mjekësore sipas përcaktimit nga mjeku i pacientit për t'u kualifikuar për asistencë financiare. Shërbimet kozmetike, kirurgjia kozmetike, shërbimet e tjera fakultative që nuk nevojiten nga ana mjekësore, shërbimet tanimë me zbritje përmes planifikimeve të paketës së çmimit, shërbimet personale (p.sh. tarifat e dhomës) dhe artikujt e volitshëm të pacientit nuk të kualifikojnë për asistencë financiare.

KUALIFIKIMI

Përcaktimi i kualifikimit për asistencë financiare bazohet në paaftësinë e vërtetuar të pacientit për të paguar shpenzimet ose artikujt për shkak të burimeve financiare të pamjaftueshme. Një formular i plotësuar aplikimi dhe dokumentacioni i kërkuar shoqërues (përfshirë, mes dokumenteve të tjera shoqëruese të renditura në aplikim, faturat aktuale, pasqyrat bankare, kthimet e taksave të vitit të mëparshëm, një letër të firmosur nga punëdhënësi, dhe çeqet e sigurimeve shoqërore ose të paaftësisë). Mossigurimi i këtyre dokumenteve, nëse kërkohet nga aplikimi, mund të rezultojë në një refuzim të asistencës financiare. Pacientët do të konsiderohen si të kualifikuar për asistencë financiare deri në 300% të nivelit federal të varfërisë. Përcaktimi i kualifikimit për asistencë financiare në përgjithësi duhet të kryhet para ose në kohën e shtrimit ose menjëherë pas kësaj. Megjithatë, situatat pas daljes nga spitali mund të ndryshojnë aftësinë e pacientit për të paguar.

Pacientët që duan të aplikojnë për asistencë financiare mund të plotësojnë aplikimin dhe ta paraqesin atë së bashku me dokumentacionin kërkuar shoqërues te Shërbimet Financiare të Pacientit (Shtojca A).

Nëse një pacient ka nevojë për të plotësuar aplikimin, pacienti mund të kontaktojë ose vizitojë departamentin e caktuar të Shërbimeve Financiare të Pacientit për vendin e shërbimeve (Shtojca B).

Kualifikimi për asistencë financiare do të merret parasysh vetëm pasi të jenë shfrytëzuar të gjitha burimet e pagesës. Beaumont Health do t'i ndihmojë pacientët të aplikojnë për sigurim me Medicaid. Ka një pritshmëri që pacientët do të bashkëpunojnë në aplikimin për sigurim. Aplikuesve nuk do t'iu refuzohet asistencë financiare bazuar në pamundësinë e tyre për të ofruar informacionin ose dokumentacionin që kjo policë apo aplikim nuk kërkon në mënyrë të hapur. Vendimi për të ofruar asistencë financiare miratohet nga ekipi i menaxhimit të Shërbimeve Financiare të Pacientit. Pasi përcaktohet që një pacient do të kualifikohet për asistencë financiare, ai pacient nuk do të marrë fatura të ardhshme për shërbimet e ofruara më parë bazuar në pagesa bruto pa zbritje.

Kjo policë ka për synim të zbatohet vetëm për banorët e Miçiganit të cilët vërtetojnë qëndrimin e tyre në Miçigan dhe banojnë brenda zonës së shërbimit të Beaumont Health. Ky kufizim i qëndrimit nuk zbatohet për asnjë pacient që kërkon shërbime të Qendrës së Urgjencës.

Në rast se një pacient beson se aplikimi i tij/saj për asistencë financiare nuk është marrë parasysh si duhet në përputhje me këtë policë ose ai/ajo nuk bien dakord me aplikimin e kësaj police në rastin e tij/saj, pacienti mund të paraqesë një kërkesë me shkrim për rimarrje në konsideratë drejtuar presidentit ose zëvendëspresidentit të caktuar të spitalit (Shtojca C), i cili do të jetë niveli përfundimtar i apelimit.

Për t'u kualifikuar për asistencë financiare, një pacient duhet të paraqesë një aplikim të saktë dhe të plotë për asistencë financiare brenda datës së kërkuar (d.m.th., periudha e aplikimit jo më vonë se dita e 240-të pasi Beaumont Health i jep pacientit deklaratën e parë të tarifimit për artikujt ose shërbimet e përfituara).

Beaumont Health do të dokumentojë në kohë përcaktimin e kualifikimit të pacientit pas marrjes së një aplikimi të plotësuar. Beaumont Health do të njoftojë pacientët për përcaktimin (nëse është e aplikueshme, përfshirë asistencën për të cilën kualifikohet individi) dhe bazat e Beaumont Health për të kryer këtë përcaktim. Borxhet mund t'i referohen vetëm një pale të tretë në një mënyrë të përputhshme me Policën e Tarifimit dhe Mbledhjes të Beaumont Health dhe në një mënyrë të përputhshme me Seksionin 501(r) të Kodit.

Kualifikimi i pacientit për asistencë financiare bazohet në krahasimin e të ardhurave familjare me Nivelin Federal të Varfërisë (FPL). Pacientët me të ardhura deri në 300% të FPL do të kualifikohen për një zbritje bazuar në shumën e tarifuar përgjithësisht (AGB). **AGB** përcaktohet çdo vit dhe bazohet në metodën e Rishikimit siç përshkruhet në Seksionin 501(r) të Kodit dhe akteve normative në të. Pacientët me të ardhura deri në 200% të FPL mund të kualifikohen për një zbritje prej 100%. Një përqindje e rishikuar e AGB do të llogaritet çdo vit dhe do të zbatohet pas ditës së 45-të pas ditës së parë të vitit fiskal, i cili përdoret për të përcaktuar llogaritjet.

Niveli i zbritjes:

Të ardhurat si përqindje e FPL	Asi
Deri në 200%	1

FATURIMI DHE MBLEDHJET

Informacioni që lidhet me policën e tarifimit dhe mbledhjeve të Beaumont Health mund të merret duke kërkuar një kopje në letër falas te numri përkatës i telefonit te vendi i shërbimit, i cili gjendet i renditur poshtë ose është në dispozicion në faqen e internetit të Beaumont Health. Beaumont.org

Në asnjë rast norma e reduktuar që iu ngarkohet pacientëve të kualifikuar për asistencë financiare për kujdesin e shërbimit të urgjencës ose shërbimet e nevojshme mjekësore nuk duhet të jetë më e madhe se AGB për këto shërbime. Në kuadër të kujdesit mjekësor të ofruar përveç kujdesit të shërbimit të urgjencës dhe shërbimeve të nevojshme mjekësore, pacientët e kualifikuar për asistencë financiare nuk do të tarifohen më tepër se pagesat bruto për një kujdes të tillë. AGB do të llogaritet të paktën bazuar në një normë vjetore. Një përqindje e rishikuar e AGB do të llogaritet çdo vit dhe do të zbatohet brenda ditës së 45-të pas ditës së parë të fillimit të vitit fiskal për të përcaktuar llogaritjet. Beaumont Health do të lejojë anëtarët e publikut

të marrin lehtësisht, me shkrim dhe kundrejt asnjë pagese, përqindjen aktuale AGB të Beaumont Health si dhe metodën me të cilën Beaumont Health ka llogaritur këtë përqindje. Gjithashtu, në përputhje me ligjin e Miçiganit, për pacientët e pasiguruar me të ardhura deri në 250% të nivelit federal të varfërisë, pagesa maksimale që do të kërkohej është 115% e normës Medicare për shërbime të tilla.

Beaumont Health do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të përcaktuar nëse një individ kualifikohet apo jo për asistencë financiare para se të angazhohet në ndonjë prej “veprimeve të jashtëzakonshme të mbledhjes”, sepse ky është termi i përdorur në Seksionin 501(r)(6) të Kodit. Beaumont Health do të miratojë një policë specifike të tarifimit dhe mbledhjeve në përputhje me Seksionin 501(r)(6) të Kodit, veçuar dhe mënjeluar nga kjo

policë, dhe do t'i reklamojë gjerësisht të dyja dhe do të bëjë kopje të policës së disponueshme të tarifimit dhe mbledhjeve. Polica e tarifimit dhe mbledhjeve do të përcaktojë veprime të jashtëzakonshme të mbledhjes, periudhën e njoftimit për informimin e pacientëve rreth policës së asistencës financiare, do të përshkruajë procedurat e aplikueshme për aplikimet e paplotësuara për asistencën financiare dhe do të përshkruajë veprimet që Beaumont Health ose një palë e autorizuar, do të ndërmarrë në rast të mospagesës.

VLERËSIMI I KRITEREVE TË TË ARDHURA FINANCIARE

Të ardhurat familjare do të jenë faktori bazë për përcaktimin e kualifikimit për asistencë financiare. Të ardhurat familjare janë një mënyrë matjeje që përdoret përgjithësisht nga qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe institucionet private. Çdo familje matet nga të ardhurat e çdo banori mbi moshën 15 vjeç. Të ardhurat përfshijnë paga dhe rroga, sigurim në rast papunësie, pagesa paaftësie, pagesa të përfituara për mbajtjen e fëmijëve, fatura të rregullta qiraje, si dhe çdo punë personale, investim ose lloje të tjera të ardhurash të përfituara në mënyrë të vazhdueshme. Kur është e mundur personi që kërkon asistencë financiare duhet të sigurojë një kopje të Kthimit të plotë të Taksave Federale së bashku me kthimin e Taksave të Miçiganit për të ndihmuar në përcaktimin e të ardhurave "familjare". Përbërësit e procesit të vlerësimit përfshijnë:

1. Statusi i personit në ngarkim

Nëse pacienti konsiderohet si një person në ngarkim të prindit ose fëmijës së rritur për sa i përket kthimit të taksave, të ardhurat e palës që pretendon se tjetra është një person në ngarkim do të merret parasysh si bazë për përcaktimin e kualifikimit.

2. Vërtetim të ardhurash

Pacientët që kërkojnë asistencë financiare duhet të sigurojnë kthimin e fundit të kërkuar të taksave së bashku me faturat e fundit të pagesave, pagesat e sigurimeve shoqërore etj. për të vërtetuar të ardhurat aktuale. Nëse të ardhurat aktuale kanë ndryshuar në mënyrë dramatike nga shumat e pasqyruara në kthimin e fundit të kërkuar të taksave, mund t'i jepet konsideratë pezullimit të një vendimi lidhur me miratimin e asistencës financiare, nëse ka baza të arsyeshme për të supozuar se nivelet e të ardhurave do të kthehen në nivelet e mëparshme.

3. Vlerësimi i të ardhurave

Çdo episod kujdesi dhe faturimi është i veçuar dhe i ndryshëm. Kualifikimet për asistencë financiare për një faturë të veçantë, nuk e kualifikon automatikisht një pacient për të njëjtën asistencë me shërbimet e ardhshme ose artikujt e përfituar.

4. Asetet

Pacientët që kërkojnë asistencë financiare janë të detyruar të japin një renditje dhe vlerë të përllogaritur të të gjithë asetëve, d.m.th. shtëpitë parësore dhe dytësore, fondet e përbashkëta, trualli i lirë, automjetet motorike etj. Kur të përcaktohet kualifikimi për asistencë financiare do të merren parasysh këto asete.

5. Llogaritë e pensionit

Llogaritë e pensionit do të njihen bazuar në vlerën e tyre si pension vjetor, ku vlera e barasvlershme vjetore i është shtuar të ardhurave familjare. 25 vjet do të përdoren si kohëzgjatja e pensionit vjetor dhe 3.5% do të përdoren si norma vjetore e rritjes.

6. Informacioni mbi përfaqësimin

Nëse pacientët nuk janë në gjendje të ofrojnë informacion të plotë financiar dhe/ose social, të ardhurat duhet të verifikohen në një mënyrë që të kualifikohen për asistencë financiare. Prandaj, disa raste mund të përcaktohen bazuar në burimet e disponueshme.

Përcaktimi i kualifikimit për asistencë financiare ose vetë asistencë financiare është subjekt i ndryshimit nëse zbulohet se informacioni është refuzuar, nëse në çdo kohë është përfituar informacion shtesë, ose nëse rrethanat ndryshojnë në çdo kohë para pagesës së llogarisë aktuale. Nëse informacioni i dhënë përcaktohet më vonë si i pasaktë, pacienti duhet të ofrojë pagesë për shërbimet ose artikujt e përfituar.

I PAKUALIFIKUAR PËR ASISTENCË FINANCIARE

Nëse pas vlerësimit të plotë të aplikimit përcaktohet se një pacient nuk kualifikohet për asistencë financiare sipas kësaj police, dhe ai nuk është i siguar, do të zbatohet policia e Zbritjes së Pagesës për Pacientin e Pasiguar.

KOORDINIMI ME POLICËN E KUJDESIT TË SHËRBIMIT TË URGJENCËS

Në të gjitha kohët, Beaumont Health do të ruajë një policë të kujdesit të shërbimit mjekësor të urgjencës që kërkon t'iu ofrosh, pa diskriminim, kujdes për kushtet mjekësore të urgjencës (brenda kuptimit të Aktit të Trajtitit Mjekësor të Urgjencës dhe Punës (EMTALA), seksioni 1867 i Aktit të Sigurimeve Shoqërore (42 U.S.C. 1395dd) individëve pavarësisht kualifikimit të tyre sipas kësaj police.

Në asnjë kohë personeli i Beaumont Health apo kontraktorët e tij nuk duhet të angazhohet në asnjë veprimtari, e cila shkurajon personat të kërkojnë kujdes mjekësor urgjence pa u diskriminuar, gjë e cila përfshin kërkesën për paradhënie të çdo tarife ose kryerjen e aktiviteteve të mbledhjes së borxhit në Qendrën e Urgjencës ose në pika të tjera spitalore ku aktivitete të tilla mund të bien ndesh me ekzaminimin e shqyrtimit mjekësor ose me trajtimin stabilizues të një gjendjeje urgjente mjekësore.

REKLAMIMI I POLICËS SË ASISTENCËS FINANCIARE

Kjo policë do të reklamohet gjerësisht te komunitetet që shërbehen nga çdo Beaumont Health. Prandaj, së paku, Beaumont Health do të ndërmarrë veprimet vijuese në një mënyrë që të jetë në përputhje me Seksionin 501(r) të Kodit, dhe çdo akt përkatës normativ, për të reklamuar gjerësisht këtë policë të asistencës financiare. Beaumont Health do të ofrojë të mëposhtmet:

- Këtë policë, Aplikimin për Asistencën Financiare të Pacientit (Aplikimi) (përfshirë udhëzimet për plotësimin e aplikimit), dhe një përmbledhje në një gjuhë të thjeshtë të policës në faqen e internetit të Beaumont Health. Beaumont.org
- Njoftim për disponueshmërinë e asistencës financiare të pacientit dhe udhëzimet për vlerësimin e kualifikimit të pacientit dhe mënyra e përfitimit të një kopjeje të kësaj police përmes: (i) paraqitjeve të dukshme publike të informacionit në Qendrën e Urgjencës, vendet e regjistrimit dhe zona të tjera të pritjes së pacientit; (ii) broshurave të pacientit dhe kopjeve përmbledhëse në një gjuhë të thjeshtë të kësaj police në Qendrën e Urgjencës, vendet e regjistrimit dhe zona të tjera të përshtatshme; dhe (iii) deklaratave në faturat e pacientit ku i këshillojnë pacientët se nëse kanë nevojë për ndihmë me pagesën e faturës, mund të kualifikohen për asistencë financiare dhe mënyra e përfitimit të një kopjeje të kësaj police.
- Kopje në letër të kësaj police, Aplikimi (përfshirë udhëzimet për plotësimin e aplikimit), dhe një përmbledhje në një gjuhë të thjeshtë të kësaj police me kërkesë të të interesuarit dhe kundrejt asnjë pagese, si në vendet publike brenda godinës spitalore ashtu edhe përmes postës.

- Pikat Beaumont Health ku kjo policë dhe Aplikimi (përfshirë udhëzimet për plotësimin e aplikimit) janë në dispozicion renditen në Shtojcën B bashkëngjitur.

Veç kësaj, Beaumont Health do të informojë dhe njoftojë banorët e komunitetave që shërbehen nga Beaumont Health rreth kësaj police në një mënyrë të arsyeshme që pritet të arrijë tek ata anëtarë të komunitetit, të cilët kanë më shumë gjasa të kërkojnë asistencë financiare dhe përdorin metoda të tjera të publikimit ose shpërndarjes sipas përcaktimit nga Beaumont Health Hospital për të reklamuar gjerësisht këtë policë.

Beaumont Health do të përgatisë një përmbledhje në një gjuhë të thjeshtë të kësaj police, e cila do të përfshijë:

- Një përshkrim të shkurtër të kërkesave të kualifikimit dhe asistencën e ofruar sipas kësaj police;
- Një adresë të drejtpërdrejtë interneti dhe vendndodhjen fizike ku mund të merren kopje të kësaj police dhe Aplikimi (përfshirë udhëzimet për plotësimin e aplikimit);
- Udhëzime mbi mënyrën e përfitimit të një kopjeje falas të kësaj police dhe aplikimit (përfshirë udhëzimet për plotësimin e aplikimit) me postë;
- Informacionet e kontaktit (d.m.th., numri i telefonit dhe adresa e Beaumont Hospital) të një anëtari të stafit, që mund të ofrojë informacione rreth kësaj police dhe aplikimit, si dhe informacione kontakti për çdo organizatë jofitimprurëse apo agjenci qeveritare identifikuar si burime efikase të asistencës nga aplikimi i Beaumont Health; dhe
- Një deklaratë që asnjë individ i cili kualifikohet për asistencë financiare, kujdes të shërbimit të urgjencës dhe shërbimet e tjera mjekësore, nuk do të tarifohet më tepër se shumatat që i ngarkohen individëve, të cilët janë të siguruar me këtë kujdes.

Për të aplikuar për asistencë financiare ose informacione shtesë mbi Policën e Asistencës Financiare, mund të kontaktoni grupin e shërbimit ndaj klientit që përshtatet me vendin tuaj të shërbimit:

Beaumont Hospital – Grosse Pointe, Beaumont Hospital – Royal Oak, Beaumont Hospital – Troy, Beaumont Hospital – Farmington Hills:

Qendra e Thirrjeve për Shërbimin ndaj Klientit në 1-248-577-9205

Beaumont Hospital – Dearborn, Beaumont Hospital – Wayne, Beaumont Hospital – Taylor, and Beaumont Hospital – Trenton:

Qendra e Thirrjeve për Shërbimin ndaj Klientit në 1-248-577-9205

Shtojca A: Adresa postare për aplikimet e përfunduara të asistencës

Beaumont Hospital – Grosse Pointe, Beaumont Hospital – Royal Oak, Beaumont Hospital – Troy, Beaumont Hospital – Farmington Hills

Beaumont Health System
750 Stephenson Highway
P.O. Box 5042
Troy, Michigan 48083

Beaumont Hospital – Dearborn, Beaumont Hospital – Wayne, Beaumont Hospital – Taylor, and Beaumont Hospital – Trenton

Beaumont Health
OakAssist Department
15500 Lundy Parkway, Suite 101
Dearborn, MI 48126

Shtojca B: Vendi për ndihmë të mëtejshme dhe/ose informacion mbi aplikimin, sipas vendit të shërbimit

**Beaumont Hospital – Grosse Pointe:
(nën kujdesin e: Patient Financial Services)**

468 Cadieux Rd
Grosse Pointe, MI 48230

**Beaumont Hospital – Royal Oak:
(nën kujdesin e: Patient Financial Services)**

3601 W 13 Mile Rd
Royal Oak, MI 48073

**Beaumont Hospital – Troy:
(nën kujdesin e: Patient Financial Services)**

44201 Dequindre Rd
Troy, Michigan 48085

**Beaumont Hospital – Farmington Hills:
(nën kujdesin e: Financial Counseling)**

28050 Grand River
Farmington Hills, Michigan 48336

Beaumont Hospital – Dearborn, Beaumont Hospital – Wayne, Beaumont Hospital – Taylor, and Beaumont Hospital – Trenton:

(nën kujdesin e: OakAssist)
18101 Oakwood Blvd
Dearborn, Michigan 48124

Shtojca C: Pika e shkallëzimit për aplikimet sipas vendit të shërbimit

Beaumont Hospital – Grosse Pointe, Beaumont Hospital – Royal Oak, Beaumont Hospital – Troy: Zëvendës Presidenti i Beaumont Hospital

Beaumont Hospital – Farmington Hills: Presidenti- Beaumont Farmington Hills

Beaumont Hospital – Dearborn, Beaumont Hospital – Wayne, Beaumont Hospital – Taylor, and Beaumont Hospital – Trenton: Zëvendës Presidenti i Beaumont Health të Ciklit të të Ardhurave

**Shtojca D: Lista e ofruesve të siguruar sipas Policës së Asistencës Financiare të
Beaumont Health**

**Beaumont Hospital – Grosse Pointe, Beaumont Hospital – Royal Oak, Beaumont Hospital –
Troy:**

Beaumont Medical Group (BMG)

Beaumont Hospital – Farmington Hills:

Infectious Diseases

Botsford Pediatrics

Botsford Podiatry

Comprehensive OB/Byn - Livonia

Comprehensive OB/Gyn - Dearborn Heights

Comprehensive OB/Byn - Redford

Essential Gynecology & Obstetrics

Botsford Primary Care Physicians

Midwest Internal Medicine Associates

Rheumatology

Farmington Village Family Practice - West

Farmington Village Family Practice - East

Botsford Dermatology Resident Clinic

Premier OB/Gyn Services - Farmington

Botsford Perinatology

Botsford Medical Center - Redford

Botsford Pulmonary & Sleep Medicine

Botsford Sleep Disorders Center

Botsford Geriatrics & Palliative Care

Midwest Urgent Care

Botsford Family Medicine Center

Botsford Family Practice Botsford

Family Care of Novi Botsford

Thoracic Surgery Center Botsford

Vascular Surgery Center MOHS

Clinic

Botsford Heart Health Center (5 locations)

Botsford Center for Internal Medicine

Northside Medical Center

Botsford Outreach Laboratory

Botsford Medical Imaging

Botsford Anesthesia

Farmington Emergency Medicine Associates

Botsford CRNAs

**Beaumont Hospital – Dearborn, Beaumont Hospital – Wayne, Beaumont Hospital – Taylor,
and Beaumont Hospital – Trenton:**

Advanced Urogynecology of Michigan, PC.

Aggarwal Ophthalmology, PLC

Allan D. Lamb, DO, PC

Allen Park Cardiology, PC

Allenwood Family Healthcare, PC

Alzohaili Medical Consultants, M.D., P.C.
Anesthesia Associates of Ann Arbor, PLLC
Anil Gupta, MD, PC
Ashar H. Khan, M.D.
Ashish Gupta, MD, PC
Associated Retinal Consultants, PC
Badhwar Associates, MD PC
Baldev Gupta, MD PC
Cancer & Transplant Consultants, PLC
Center for Individualized Medicine, PLLC
Children's Eye Care, PC
Children's Orthogenic Institute, P.L.L.C.
Christopher DeAngelis, DO, PC
Comprehensive Hospital Care, PC
Consultants in Ophthalmic Facial Plastic Surgery, PC
Critical Care Medicine Associates, PC
Critical Care Medicine Partners, PC
Daniel Zahari, DPM, Southgate Foot & Ankle Center, PLLC
David G. Patterson, D.O., P.C.
David W. Law, D.O., P.C.
Dearborn Laser and Cosmetic Center, PLLC
Dearborn Oral and Maxillofacial Surgery Associates, P.C.
Debbie Woody, DPM PLLC
Devinder Mahajan, MD PC
Douglas J. Zakolski D.O., P.C.
Downriver Institute for Women's Health, PC
Downriver Internal Medicine Associates, PLC
Downriver Internal Medicine, P.C.
Downriver Neurology, PC
Downriver Obstetrics and Gynecology, PLC
Downriver Pediatric Associates, PC
Dr. Lloyd Beaudry, PLLC
Dr. Zachary H. Lewis, PC
Drs. Harris, Birkhill, Wang, Songe & Associates, PC
Eastside Dermatology, PC
Eye Care Providers of Michigan PC
Family Health, P.C.
Flat Rock Cardiology, PC
Frederick L. Lopatin, DO, PC
Fuad Turfah, MD PC
Glaucoma Center of Michigan, PC
Glendale Neurological Associates, P.C.

Gregory E. Stephens, D.O., P.C.
Grekin Skin Institute
Hamid Sattar, MD PC
Helen Etemadi, DO, PC
Henry Ford Wyandotte Hospital Downriver Cardiology
Hilbrich Dermatopathology Laboratory, P.C.
Imad Al--Azem, MD, PC
Independent Medical Associates, PC
Jean M. Holland, MD PC
Jiab Suleiman, D.O., P.C.
John E. Bodell, D.O., P.C.
Jolly Neurological Clinic, PC
Joseph Finch, D.O., P.C.
Joyce Vaclav, DO, PC
Junaid Ghadai, MD, PC
Kamal Gupta, MD, PC
Lawrence D. Castleman, MD, PC.
Livonia Dermatology, PLLC
Mamdouh Abdulrazzak, MD PC
Marc J. Milia, MD PC
Marcia VanderBroek, D.O., P.C.
Margaret A. Lutsic, D.O., P.C.
Marla Price, DO, PC
Martin A.V. Tuma, Vascular Surgery, PLLC
Mehran Mirkazemi, DO, PLLC
Metro Ortho Trauma, PLLC
Metro Shores Internal Medicine, PLLC
MH Hakim, MD, PC
Michael Goldfarb, MD, PC
Michael Whitworth, DO
Michigan CCA, PLC
Michigan Comprehensive Fertility Center, PC
Michigan Cornea Consultants, PC
Michigan House Physicians, PC
Michigan Orthopaedic Trauma Specialists, PC
Michigan Pediatric Surgery Associates
Michigan Pediatrics Group, PLLC
Michigan Perinatal Associates, PC
Michigan Surgery Specialists, PC
Millennium Medical Group--South, PLLC
Mohamad H. Bazzi, MD PC
Mohammad J. Saleh, MD PC

Morsi Pediatric, PC Mustafa
S. Bohra MD, PLC Nazia Adil,
MD PLLC Nephron Clinic, PC
Neurology Care Center, Inc.
Nilesh Patel, MD
Nsima Usen, DPM, MPH, PC
Oakleaf Neurology and Sleep, PC, Christina DeSousa, MD, MPH
Ophthalmology Acquisition, PLC
Orthopedic Associates, PC
Pamela Morrison, DPM
Parmod K. Mukhi, M.D.
Parvez Kahn, M.D., P.C.
Parvez Khan, MD PC
Patel Advisors, LLC
Personal Health Care, P.C.
Plastic Surgery Clinic, P.C. Precision
Orthopedics, PC Psychiatric
Consulting Services, P.C. Rahmani
Eye Institute P.C.
Raj Gupta, MD PC
Richard P. Laskowski, D.O., P.C.
Rick A. Poston, DO, PC
S. Talib Raza, PC
Senior Care Medical Group, PLLC
Simpson Holzworth, D.O., P.C.
SL Husain Hamzavi, MD PC
Somerset Skin Centre, P.C.
Someswara Navuluri, MD
South Valley Internal Medicine, PC
Southeast Internal Medicine, PLLC
Steven J. Serra, D.O., P.C.
Steven Richard Papp, D.O., P.C.
Sunstrum Medical Associates, P.C.
Surjit Mahal, MD
Switch Eye Center, P.C.
Tae W. Park, M.D.
Therapeutic Encounters, PC
Thomas G. Gazdecki, DO, PC
Trenton Surgical, PC, John C. Baumann, DO PC
Venocure, PLLC
Vicki Anton--Athens, DPM, PC

Vijaya C. Ramesh, M.C.
Wassim Younes, MD PLC
Wayne State University Physician Group (WSUPG)
Westland Quality Health Care, PC
Zachary Lewis, D.O
Zachary Lewis, D.O
Emergency Professional Serv Inc
Garden City Hospital
MAINWARING PATHOLOGY GROUP PC
Michigan Ear Institute
Oakwood Dental PC Pics
and Pacs Inc Southshore
Oral Surgery